



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/22 Nr. i ftoq/Br.str./No pg 405
Data/Datum/Dato 28/12/2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 6 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2013"), nenit 4 paragrafi 1 pika 1.5 lidhur me nenin 14 paragrafi 1 pika 1.7 i Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.12.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit të transportit rrugor lokal në Komunën e Rahovecit 2022-2027

1. Me këtë vendim miratohet Plani i transportit rrugor lokal në Komunën e Rahovecit 2022-2027.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i transportit rrugor lokal në Komunën e Rahovecit 2022-2027.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Rahovecit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Shërbimit të Kuvendit,
- Kryetarit të Komunës,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.405/22
Datë: 28.12.2022

